



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
Këshilli i Gjykatës

Nr. 27 Prot.

Tiranë, më 01/04 /2021

V E N D I M

Nr. 47, Datë 01/04 /2021

PËR  
CAKTIMIN E GJYQTARËVE NË PËRBËRJE TË KOLEGJEVE TË GJYKATËS SË  
LARTË SI DHE CAKTIMIN E GJYQTARËVE NË PËRBËRJE TË TRUPAVE  
GJYKUES TË SECILIT KOLEGJ

Në mbështetje të pikave 2 dhe 3 të nenit 23 si dhe të germës “ç” të nenit 38 të ligjit nr. 98/2016 “Per organizimin e pushtetit gjyqësor ne Republikën e Shqipërisë”, pasi shqyrtoi materialin me shkrim që përmban të dhënat mbi numrin, llojin, natyrën dhe kohën e paraqitjes së çështjeve gjyqësore dhe numrin e gjyqtarëve e të këshilltarëve ligjore në detyrë pranë Gjykatës së Lartë, si edhe pasi vlerësoi mendimin e dhënë nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, Këshilli i Gjykatës së Lartë në mbledhjen e datës 01.04.2021,

V E N D O S I :

1. Caktimin e gjyqtarëve në përbërje të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, si më poshtë vijon:

**I) KOLEGJI PENAL**

Në përbërje të **Kolegjit Penal** caktohen gjyqtarët :

z. Ilir Panda  
z. Sandër Simoni  
zj. Albana Boksi  
z. Klodian Kurushi  
z. Sokol Binaj

## II) KOLEGJI CIVIL

Në përbërje të Kolegjit Civil caktohet gjyqtari :

z. Ervin Pupe

## III) KOLEGJI ADMINISTRATIV

Në përbërje të Kolegjit Administrativ caktohet gjyqtari :

z. Sokol Sadushi

2. Caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykuese të secilit Kolegj të Gjykatës së Lartë si më poshtë vijon:

### I) KOLEGJI CIVIL

Për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore **civile** me trupë me 3 gjyqtarë, përbërja e trupave gjykues është si vijon:

**Trupi gjykues 1**

z. Ervin Pupe  
zj. Albana Boksi  
z. Sandër Simoni

**Trupi gjykues 2**

z. Ervin Pupe  
z. Sokol Sadushi  
z. Ilir Panda

3. Shqyrtimi i çështjeve civile nga trupi gjykues nr. 1 bëhet çdo javë (ditën e mërkurë), ndërsa shqyrtimi i çështjeve nga trupi gjykues nr. 2 bëhet një herë në dy javë (ditën e hënë).

### II) KOLEGJI PENAL

Për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore **penale** me trupë me 3 gjyqtarë, përbërja e trupave gjykues është si vijon:

**Trupi gjykues 1**

z. Ilir Panda  
zj. Albana Boksi  
z. Klodian Kurushi

**Trupi gjykues 2**

z. Ilir Panda  
z. Sokol Binaj  
z. Sandër Simoni

4. Shqyrtimi i çështjeve penale bëhet nga një trupë për çdo javë (ditën e martë)

### III) KOLEGJI ADMINISTRATIV

Për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore **administrative** me trupë me 3 gjyqtarë, përbërja e trupave gjykues është si vijon:

**Trupi gjykues 1**  
z. Sokol Sadushi  
z. Sokol Binaj  
z. Klodian Kurushi

**Trupi gjykues 2**  
z. Sokol Sadushi  
z. Ilir Panda  
z. Ervin Pupe

5. Shqyrtimi i çështjeve administrative nga trupi gjykues nr. 1 bëhet çdo javë (ditën e enjte), ndërsa shqyrtimi i çështjeve nga trupi gjykues nr. 2 bëhet një herë në dy javë (ditën e hënë).

6. Në rastin e shqyrtimit të çështjeve gjyqësore me trup gjykues të përbërë me 5 (pesë) gjyqtarë, kur është rasti, 2 (dy) anëtarët plotësues të trupit gjykues caktohen nga gjyqtarët e trupit tjetër gjykues të Kolegjit përkatës. Kur është rasti i heqjes dorë apo i përjashtimit nga gjykimi i çështjes, zëvendësimi i gjyqtarit bëhet me short me një gjyqtar nga trupa tjetër e Kolegjit përkatës, dhe kur kjo nuk është e mundur, me një gjyqtar të trupave gjykuese të Kolegjeve të tjera.

7. Çështjet për të cilat janë caktuar datat e shqyrtimit në dhomë këshillimi apo seancë gjyqësore të përfundohen nga trupa gjyqësore e krijuara para hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

8. Sipas kompetencave të përcaktuara në nenin 25 të ligjit nr.98/2016, Kancelari i Gjykatës së Lartë të procedojë me realizimin e procedurave të shortit për ndarjen e të gjitha çështjeve gjyqësore, sipas llojit të tyre, mes gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

9. Ky vendim t'i komunikohet gjyqtarëve, Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe Kancelarit të Gjykatës.

10. Vendimet e Këshillit të Gjykatës nr. 1, datë 09.04.2020 "*Per caktimin e gjyqtarëve në përbërje të kolegjeve të Gjykatës se Lartë*" dhe nr. 2 datë 09.04.2020 "*Per caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykues të kolegjeve të Gjykatës se Lartë*" shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

ANËTAR  
Sokol SADUSHI

ANËTAR  
Ilir PANDA

ANËTAR  
Kelment GRECA

